



## Shpallje Publike

Në pajtim me Ligjin për ndërmarrjet publike (Ligji 03/-L-087) , (neni21.3) dhe me Vendimin e Bordit të Drejtoreve nr.658 të datës 01.02.2019 miraton kërkesën ndryshim/ploteisim të makro-skemes në fuqi të KEK-ut sh.a.dhe përfshirjen e e pozitës “Zëvendës Drejtor Menaxhues të KEK-ut”.

### Titulli; Zëvendës Drejtor Menaxhues i KEK-ut

#### Detyrat dhe përgjegjësitë :

Zëvendës i Drejtorit Menaxhues, mbështet Drejtorin Menaxhues në zhvillimin e veprimtarisë së KEK-ut dhe i raporton drejtpërdrejtë Drejtorit Menaxhues dhe është anëtarë i lartë i ekzekutivit të KEK-ut.

Zëvendës Drejtori Menaxhues, ka për të siguruar menaxhim të përshtatshëm në pajtueshmëri me kërkesat ligjore, rregullative dhe praktikat me të mira profesionale.

Zëvendës Drejtori Menaxhues zhvillon strategji për KEK-un, në mënyrë që afarizmi i saj të ketë performancë pozitive dhe të qëndrueshme, në harmoni me rregulloret e publikuara dhe niveleve të autorizimeve.

Zëvendës Drejtori Menaxhues është përgjegjës për kordinim të aktiviteteve operative të Divizioneve të Korporatës. Për më tej, Zëvendës Drejtori Menaxhues do të ketë përgjegjësi të veçantë për shtytjen e iniciativave afariste kryesore të caktuara si aktivitetet e tanishme në të gjitha Divizionet e KEK-ut dhe menaxhimin e përgatitjes dhe implementimit të planeve vjetore afariste si dhe ndonjë detyrë të veçantë që i caktohet nga ana e Drejtorit menaxhues, Zëvendës Drejtori Menaxhues do të ketë po ashtu përgjegjësi të veçantë për vazhdimin e programit të tanishëm të zvoglimit të kostove në KEK

#### Detyrat dhe përgjegjësitë specifike:

Zëvendës Drejtori Menaxhues është përgjegjës për koordinimin e zhvillimit dhe funksionimin e afarizmit të KEK-ut. Detyrat dhe përgjegjësitë e tij specifike janë që të:

- Udhëheq zhvillimin e një plani të biznesit dhe të menaxhoj implementimin e tij,
- Vendors sisteme dhe procedura për menaxhimin efektiv të KEK-ut,
- Mbikëqyr aktivitetet e Drejtorëve të Divizioneve të cilët i raportojnë drejtpërdrejt atij,
- Mbikëqyr aktivitetet e zhvillimit dhe implementimit të projekteve kapitale, në bazë të planeve të aprovuara,
- Mbikëqyr aktivitetet e zhvillimit profesional dhe administrimin e stafit të KEK-ut
- Përgatit raporte tremujore dhe vjetore për aktivitetet afariste për rishikim nga Drejtori Menaxhues,
- Bënë ndërlidhjen mes të gjitha Divizioneve të KEK-ut duke siguruar një kuptim dhe çasje të përbashkët në mesin e gjithë Drejtorëve Ekzekutiv ndaj iniciativave kryesore afariste për të cilat Zëvendës Drejtori Menaxhues është përgjegjës.
- Kordinon aktivitetet investive dhe implementimin e tyre.
- Këshillimin dhe raportimin ditor për Drejtorin Menaxhues lidhur me progresin e iniciativave kyqe afariste.

- Zëvendësimin e Drejtorit Menaxhues në mungesë të tij/saj nga puna. Kryerjen e detyrave të veqanta sipas kërkesës së Drejtorit Menaxhues.
- Ndërlidhjen me palët e interesuara kryesore (QK, MF, MZHE, donatorë, etj.) dhe përfaqësimin e KEK-ut kudo që kërkohet nga ana e DM.
- Kontribuon në politikat dhe aktivitetet e vendimmarrjes së ekipit menaxhues të KEK-ut
- Kryen edhe detyra tjera, që mund t'ia caktojë Drejtori Menaxhues për një funksionim më efektiv të KEK-ut.

#### **Kualifikimet dhe aftësitë:**

- Duhet të ketë kualifikime përkatëse Universitare Fakulteti Teknik inxhinier i diplomuar – master ne fushat perkatese.
- Duhet të ketë përvojë të punës 5 vjeqare qe nderlidhen me hartimin dhe menaxhimin e projekteve.
- Duhet të ketë njohuri të gjëra për proceset dhe procedurat institucionale.
- Duhet të tregojë aftësi të shkëlqyeshme komunikuese.
- Duhet të jetë në gjendje të marrë vendime nën presion të kohës në një ambient kompleks dhe nganjëherë të paqartë.
- Duhet të ketë njohuri të gjërë të punëve në KEK dhe të jetë i njoftuar në tërësi me kushtet e punës dhe vështirësitë në të gjitha divizionet e KEK-ut.
- Aftësia për të arritur rezultate të mira në punë ekipore,
- Aftësi të dëshmuar në zhvillimin e kapaciteteve njerëzore,

#### **Aplikimi**

Për pozitën e shpallur Aplikacionet do të pranohen vetëm nga kandidatët të cilët i plotësojnë kërkesat e parashtruara në konkurs, i cili do të publikohet në shtypin ditor dhe në Ueb faqen e KEK-ut Vlerësimi i kandidatëve dhe intervista do të bëhet në një kohë optimale pas përfundimit të afatit për aplikim.

KEK-u, e mbanë të drejtën e formimit të listës së shkurtuar me aplikantët në harmoni me politikat e aprovuara të kompanisë.

Kandidatët të cilët ftohen për intervistim duhet t'i sjellin me vete të gjitha dokumentet të cilat i dëshmojnë shënimet e theksuara në aplikacion.

#### **Forma e aplikimit**

- Kandidatët së bashku me aplikacionin duhet të dorëzojnë edhe vërtetimin nga gjykata kompetente se të njëjtit nuk janë nën hetime – jo më të vjetër se 6 muaj, si dhe

E-mail adresa ku duhet të aplikohet është: Sadete.Musliu@kek-energy.com Afati i shpalljes është nga data **19.02.2019** deri me datën **11.03.2019 ne ora 16.00**

Aplikacionet pas afatit të paraparë apo të pakompletuara nuk do të pranohen.

Prishtinë, 19.02.2019

Sekretari Korporates Energjetike te Kosoves

